

PRODUKTI I BRENDSHËM BRUTO

2025*

Instituti i Statistikave (INSTAT), në përputhje me Kodin e Praktikave të Statistikave Evropiane dhe Politikën e Harmonizuar Evropiane për Rishikimin e Statistikave Makroekonomike (HERP – eng), publikon seritë e përditësuara kohore të Llogarive Kombëtare, 1995 – 2025*, në terma vjetorë dhe Q1.1995 – Q1.2026 në terma tremujorë, i cili sikurse ishte bërë i ditur publikisht, do të realizohej në Qershor 2026.

Rishikimi i Llogarive Kombëtare 2026, përfaqëson përditësimin më të rëndësishëm metodologjik të sistemit të Llogarive Kombëtare, pas rishikimit të vitit 2024, me synim rritjen e cilësisë, koherencës, plotshmërisë së të dhënave dhe krahasueshmërisë të statistikave makroekonomike.

Rishikimi i vitit 2026 konsiston në:

- integrimin e burimeve të reja statistikore dhe administrative,
- përmirësimin e metodologjive të vlerësimit dhe harmonizimin e mëtejshëm me standardet evropiane.

Burimet kryesore të përdorura përfshijnë:

- rezultatet e Cens të Popullsisë dhe Banesave 2023;
- burimet administrative të përditësuara;
- implementimin e klasifikimit të ri COICOP 2018 “Klasifikimi i Konsumit Individual, sipas Qëllimit (COICOP 2018)”, në vlerësimin e treguesit “Shpenzime e konsumit final të familjeve”;
- zhvillimin e metodave të reja për vlerësimin e Konsumit të Kapitalit Fiks, punësimit dhe ekonomisë së pavrojtuar.

Si rezultat i përmirësimeve, rishikimi i serive kohore ka ndikuar në nivelin e Prodhimit të Brendshëm Bruto (PBB), duke rezultuar në ndryshim në terma reale të PBB-së.

PBB-ja me çmime korrente u vlerësua:

- 2,648,505 milion lekë për vitin 2025 nga 2,650,990 milion lekë bazuar në PBB-në tremujore, dhe
- 2,517,280 milion lekë në vitin 2024 nga 2,517,820 milion lekë nga vlerësimet gjysmëfinale..

Rritja reale vlerësohet:

- Për vitin 2025, 3,66 % nga 3,79% e publikuar më parë bazuar në vlerësimet e PBB-së tremujore;
- Për vitin 2024, rritja reale vlerësohet 4,03 % nga 4,05%, bazuar në vlerësimet gjysmëfinale të publikuar më parë.


TABELA 1. PRODHIMI I BRËNDSHËM BRUTO, NË VLERË NOMINALE ME ÇMIME KORRENTE, 2021 – 2025*

Vitet	PBB-para rishikimit million lekë	PBB e rishikuar million lekë	Diferenca në %	Diferenca në vlerë
2021	1,866,672	1,870,218	0.19	3,546
2022	2,149,741	2,150,558	0.04	817
2023*	2,364,276	2,365,186	0.04	910
2024	2,517,820	2,517,279	(0.02)	(541)
2025*	2,650,990	2,648,505	(0.09)	(2,485)

TABELA 2. RITJA REALE E PRODHIMIT TË BRËNDSHËM BRUTO, 2021- 2025*

Vitet	PBB-para rishikimit, në %	PBB e rishikuar, në %	Ndryshimi
2021	8.97	8.92	-0.05
2022	4.83	4.49	-0.34
2023*	4.02	4.01	-0.01
2024	4.05	4.03	-0.02
2025*	3.79	3.66	-0.13

FIG. 1 PBB DHE RITJA EKONOMIKE, 2021 – 2025*



2025* Të dhëna gjysëmfinale

Shënim për përdoruesit:

Të dhënat e detajuara vjetore sipas aktiviteteve ekonomike janë të disponueshme në databazën statistikore të INSTAT: [Produkti i brendshëm bruto](https://www.instat.gov.al/), si dhe në seksionin e tabelave në website në temën: [Produkti i brendshëm bruto](https://www.instat.gov.al/)

Metodologjia

Rishikimi sipas metodës së prodhimit:

Përmirësimet metodologjike

- Integrimi i rezultateve të Censit 2023 në vlerësimin e qirasë së imputuar, stokut të banesave, konsumit të kapitalit fiks dhe aktivitetit të pasurive të paluajtshme.
- Implementimi i Metodës së Inventarit të Përhershëm (PIM) për përmirësimin e vlerësimit të kapitalit fiks.
- Përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit të ekonomisë së vrojtuar dhe ekonomisë së pavrojtuar, duke përdorur burime statistikore dhe administrative më të plota, si dhe përmirësimi i matjes së punësimit informal përmes konceptit FTE.

Ndikimi në treguesit kryesorë

- Ndikim minimal në nivelin e përgjithshëm të PBB-së (jo më shumë se $\pm 0.04\%$ për vitet 2022–2024), duke ruajtur stabilitetin e agregatëve makroekonomikë.
- Përmirësim i cilësisë së vlerësimit të Vlerës së Shtuar Bruto sipas aktiviteteve ekonomike, veçanërisht në sektorët e pasurive të paluajtshme, ndërtimit, akomodimit dhe shërbimeve, si dhe në administratën publike.
- Rritje e koherencës dhe besueshmërisë së vlerësimeve të prodhimit në përputhje me standardet ESA 2010.

Rishikimi sipas metodës së Shpenzimeve

Përmirësimet metodologjike

- Zbatimi i klasifikimit të ri **COICOP 2018**, duke përmirësuar klasifikimin e shpenzimeve të konsumit final të familjeve.
- Përmirësimi i metodologjisë së vlerësimit të **Formimit Bruto të Kapitalit Fiks (GFCF)**, veçanërisht për investimet në banesa, bazuar në rezultatet e Censit 2023 dhe burime të tjera të përditësuara.

Ndikimi në treguesit kryesorë

- Shpenzimet e konsumit final të familjeve u ristrukturuan sipas COICOP 2018, duke rritur krahasueshmërinë ndërkombëtare;
- Investimet në banesa u rishikuan në rritje me 6–7% për periudhën 2022–2024, duke përmirësuar vlerësimin e GFCF.
- U përmirësua matja e investimeve, ndryshimeve në inventarë dhe ndërtimeve për llogari vetjake, duke forcuar koherencën ndërmjet metodës së shpenzimeve dhe metodës së prodhimit.

Rishikimi sipas metodës Metodës së të Ardhurave***Përmirësimet metodologjike***

- Integrimi i të dhënave të punësimit të rikalibruara mbi bazën e Censit 2023 dhe përdorimi i konceptit Full Time Equivalent (FTE) për vlerësimin e inputit të punës.
- Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e kompensimit të punonjësve dhe përditësimi i klasifikimit të Qeverisë së Përgjithshme në përputhje me ESA 2010/GFSM 2014, duke përfshirë edhe njësitë ekstra-buxhetore.

Ndikimi në treguesit kryesorë

- Përmirësim i vlerësimit të kompensimit të punonjësve, fitimit operativ bruto, të ardhurave mikse dhe taksave neto mbi produktet.
- Rritje e koherencës ndërmjet statistikave të punësimit, dhe agregatëve të Llogarive Kombëtare.

Rishikimi i Llogarive Kombëtare sipas sektorëve institucionalë dhe zgjerim i serisë kohore 2010 – 2025****Përmirësimet metodologjike***

- Përmirësimi i klasifikimit të njësive institucionale në përputhje me ESA 2010.
- Integrimi i burimeve të reja statistikore dhe administrative në përpilimin e Llogarive sektoriale.
- Përditësimi i llogarive të Qeverisë së Përgjithshme (S.13) dhe sektorëve të tjerë institucionalë, duke siguruar koherencë më të lartë me Llogaritë Kombëtare.
- Përmirësimi i metodologjisë për vlerësimin e transaksioneve, të ardhurave dhe shpenzimeve ndërmjet sektorëve institucionalë.

Ndikimi në treguesit kryesorë

- Përmirësim i cilësisë së treguesve të të ardhurave, kursimeve, investimeve dhe kapacitetit/nevojës për financim sipas sektorëve institucionalë.
- Rritje e koherencës ndërmjet Llogarive të Sektorëve Institucionalë, Llogarive Kombëtare dhe statistikave të financave publike.